



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.800/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Gyltene Sylejmani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Drita Rrahmani kandidate për anëtarë për Kuvendin Komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Drita Rrahmani kandidate për anëtarë për Kuvendin Komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 19:10, ka pranuar apel nga Drita Rrahmani kandidate për anëtarë për Kuvendin Komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Lipjan, me të cilin pretendon se në vendvotimet 1321e/1R, 1329e/1R, 1317e/4D, 1307e/1R, 1303e/1R, 1303e/2R, 1303e/3D nuk përputhen raportet e vëzhguesve me Formularët e Rezultateve Përfundimtare.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazeshemeris së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti

## **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se, apeluesja nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e saj ankimore. Prandaj Paneli apelin e apelueses e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.800/2017 me datën 12.11.2017.



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.